



Instituti Ndërkombëtar
i Mendimit Islam (IIIT)



Instituti Shqiptar i Mendimit
dhe i Qytetërimit Islam (AIITC)



LETËR FAENDERIMI PËR PJESËMARRJE NË
KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE

*“ARSIMI ISLAM TE SHQIPTARËT: SFIDA DHE
PERSPEKTIVA”*

I nderuar Z. Bahri Aliu,

Kam kënaqësinë që në emër të organizatorëve të konferencës ndërkombëtare **“Arsimi islam te shqiptarët. Sfida dhe perspektiva”** t’ju drejtoj këtë letër falënderimi për pjesëmarrjen tuaj në takim, si panelist me referatin:

Medreseja Isa Beu – Edukimi Islam në Maqedoni

Punimi juaj ishte një kontribut pozitiv për zhvillimin me sukses të konferencës, me pjesëmarrës nga specialistë të arsimit islam në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë, Bosnje & Herzegovinë dhe Austri.

Shpresojmë se ky tubim shkencor do të shërbejë si pikënisje për ta thelluar më tej komunikimin dhe bashkëpunimin mes të interesuarve në këtë fushë.

Në këtë kuadër, ju ftojmë të na jepni vlerësimet tuaja për konferencën si dhe sygjerimet për temat që mund të trajtohen në tubimin e ardhshëm.

Me dëshirën që bashkëpunimi reciprok mes nesh të thellohet edhe më tej, ju urojmë suksese dhe mbarësi në aspektin profesional dhe atë personal.

Bashkëngjitur do të gjeni disa foto të përzgjedhura nga konferenca Merespekt,

Koordinatorja e konferencës **Anisa Hykaj**





Alejkum selam,

ishte kënaqësi të marrësh pjesë aktive në Konferencën që organizuat Ju ***"Arsimi Islam te shqiptarët: sfida dhe perspektiva"***. Brenda dy ditëve dëgjuam referate të mira që mbase për herë të parë i qasen në formën që prezentuan. Dëgjuam të dhëna, mendime, konstatime dhe sugjerime nga ma të ndryshmet, por gjithmonë në funksion të mbarvajtjes së punës së Konferencës në fjalë. Unë, personalisht isha i nderuar që isha pjesë e kësaj Konference. Besoj se Instituti i Juaj do t'i botojë referatet e

prezentuara edhe pse sipas mendimit tim Konferencës i munguan konkluzat të cilat mbase do të ishin në interes të institucioneve relevante e pse jo edhe për entet edukativo-arsimore të shqiptarët. Kujtoj se me sugjerimet që po ua drejtojmë mbase do të mbushim këtë shpraztirë.

Për një takim tjetër, mendoj se do të ishte me interes që edhe ne si botë shqiptare të dëshmojmë se jemi pjesë e pandarë e botës Islame, ndaj do të ishte mirë që burrat e pendës t'i qasen temës:

"Kultura – tradita Islame të shqiptarët."

Ju uroj punë të mbarë, fitore të reja e dhashtë All-llahu xh. sh. që të keni shëndet e vullnet. Selam të gjithë stafit për angazhimin që patët e në mënyrë të veçant Dr. Ramiz Zekës dhe Dr. Faruk Borovës.

Prof. Bahri Aliu, Tetovë.